



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 69 dt.28.06.1995

PER ORGANIZIMIN E NJE VIZITE E VENDOSJEN E LIDHJEVE ME
KESHILLIN BASHKIAK TE ROMES ITALI.

Lidhjet e vendit tonë me Italinë fqinje janë zgjeruar në të gjitha fushat. Në këtë kuadër Komisionet e përhershme, me konsensus e shohin të nevojshme dhe propozojnë që të vendosin kontakte edhe midis dy organeve të pushtetit lokal Këshillit Bashkiak të Romës dhe Këshillit Bashkiak të Tiranës.

Mbi sa më sipër, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.28.06.1995.

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e komisioneve të përkohshme për vendosjen e lidhjeve me Këshillin Bashkiak të Romës dhe të ngarkojë seksionet përkatëse të Bashkisë me konkretizimin e tyre.
2. Të miratojë organizimin e një vizite pune 5 ditore (duke përfshirë dhe udhëtimin) për shkëmbim përvoja me Këshillin Bashkiak të Romës, me pjesmarrjen e antarëve të Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe disa punonjësve të aparatit që lidhen më tepër me veprimtarinë e Këshillit gjithësj 40 vetë. Përcaktimi i

punonjësve të aparatit të bëhet me konsultim me Kryetarin e Bashkisë.

3. Të synohet që vizita të realizohet në muajin Shtator por në vartësi të procedurave që lidhen me rakordimin me palën Italiane, vizat transporti.
4. Shpenzimet për organizimet e kësaj vizite përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Bashkisë për vitin 1995.
5. Ngarkohet Seksioni i Ekonomisë dhe i Buxhetit si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Financës të paraqesë për miratim në mbledhjen më të afërt preventivin e detajuar të shpenzimeve për organizimin e kësaj vizite.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA